



SHOQATA MIQTE E MUZIKES “ROZAFÄ EXPRESSION”
NE BASHKËPUNIM ME KORIN “UTRECHT TRAVEL SINGERS”
JEP NË QËNDREN E KËNDIMIT KORAL NË SALLËN
“MARIANNE GRAF”

“MBRËMJE KULTURORE SHQIPËRI-HOLLANDË”



NË REPERTOR PJESË KORALE NGA VENDE TË NDRYSHME TË BOTËS
HOMAZH KOMPOZITORIT TË SHQUAR SHKODRANË PRENK JAKOVA
NË 100 VJETORIN E LINDJES

TE PREMTEN, ME DATË 28.04.2017 ORA 19.00

MJESHTER KORI: INES LEIJEN

PROF. ZEF ÇOBA

KONCERT MAESTER: FLONJA PRENDA

FTOHENI TË MERRNI PJESË.

SPONSOR: MINISTRIA E KULTURËS



PROGRAMI

KORI: "UTRECHT TRAVEL SINGERS"

1. TRAD., ARR. BREMER—"KOMT VRIENDEN IN HET RONDEN" HOLLANDE
2. R.GELDOF/K.BIKKEMBERGS"LIEVE MAGNOLIA, LIEVELING" HOLLANDE
3. TRAD. – "YAREMGORANI" ARMENIA
4. TRAD. – "SAT'RPIALO" GEORGIA
5. TRAD. – "OKHKARAVALI" GEORGIA
6. B. JOEL – "GOODNIGHT MY ANGEL" USA
7. S. JOPLIN – "AUNT DINAH" USA
8. TRAD. – "VALLE E REXHES" SHQIPERI
9. TRAD. – "VAJTA N'ELBASAN" KOSOVE

MJESHTER KORI: INES LEIJEN

KORI: "ROZAFI EXPRSSION"

NË NDERIM TË 100 VJETORIT TË LINDJES SË KOMPOZITORIT PRENK JAKOVA(1917-1969),
VITI 2017 ËSHTE SHPALLUR: VITI PRENK JAKOVA.

1. P. JAKOVA –"AVE MARIA" SHQIPERI
2. P. JAKOVA – ARIA E MARËS NGA OP."MRIKA" SOLISTE: OLTA JUBA SHQIPERI
3. ENRIQUE FABREZ (1926) – "BOLERO SEVILIANAS"
SOLISTE: ERINDA AGOLLI / SHOQËRON: KORI SPANJE
4. SPIRITUEL – "I CAN TELL THE WORLD" USA

MJESHTER KORI: ZEF ÇOBA

"ROZAFI EXPRSSION" & "UTRECHT TRAVEL SINGERS"

1. P. UUSBERG(1986) – "MUUSIKA" ESTONIA
2. L. BERNSTEIN(1918-1990) – "ONE HAND, ONE HEART" USA

MJESHTER KORI: INES LEIJEN

DORËZIMI I ÇERTIFIKATËS PËR SEMINARIN E ZHVILLUAR ME "UTRECHT TRAVEL SINGERS"
ME TEMEN: "NJOHURI MBI MUZIKEN SHQIPTARE", MBAJTUR NGA PROF. ZEF ÇOBA

1. P. PALI, S. GJONI – "LULE BORE" SHQIPERI
2. D. CHUPLEVSKI(1933-2001) – „RUM, DUM, DUM“ MAQEDONI
3. M. VAKO(1930) – "BIE LODRA" SHQIPERI
4. B. DE MARZI(1935) – "SIGNORE DELLE CIME" ITALI

MJESHTER KORI: ZEF ÇOBA



KORI “KENGËTARËT UDHËTUES TË UTRECHTIT”

KORI “KËNGËTARËT UDHËTUES TË UTRECHTIT” U KRIJUA NË VITIN 2006 DHE E KA PREJARDHJEN NGA QYTETI I UTRECHTIT (HOLLANDË). AI ËSHTË NJË KOR MIKS AMATOR, I PËRBËRË NGA 30 ANËTARË. SHUMICA E TYRE, KËNDOJNË NË KOR ÇDO JAVË, POR DISA HERË NË VIT ANËTARËT MARRIN PJESË NË NJË PROJEKTE TË NDRYSHME SI P.SH. NË KËNGËT E KRISHTLINDJEVE, MUSIKË KAUKAZIANE, ETJ.

KORI ËSHTË KRIJUAR DHE UDHËHIQET NGA ZNJ. INES LEIJEN. AJO KA STUDIAR MUZIKË NË KONSERVATORIN E UTRECHTIT DHE KA DREJTUAR KORE TË NDRYSHËM GJATË KARRIERËS. AJO ORGANIZON SEMINARE NË KORE TË NDRYSHËM, SI DHE LUAN NË SAKSOFON E ORGANIZON GRUPE SALSA, JAZZ DHE GIPSY”.

NJË NGA AKTIVITETET KRYESORE TË UTS JANË UDHËTIMET DHE SHKËMBIMET E EKSPERIENCAVE ÇDO DY VJET, ME KORE TË VENDEVE TË NDRYSHME. KORI QËNDRON NJË JAVË NË NJË VEND TJETËR, ME QËLLIM QË TË MËSOJË RRETH KULTURËS DHE MUZIKËS SË KËTIJ VENDI. MË TEJ, SHKËMBIMET SYNOJNË ORGANIZIMIN E TRAJNIMIT TË KORIT NGA EKSPERTË TË KËTYRE VENDEVE, ME QËLLIM PASURIMIN E REPERTORIT ME PJESË TË REJA, SI DHE REALIZIMIN E PERFORMANCAVE ME NJË KOR TË NJË VENDI TJETËR. DERI TANI, UTS KA ORGANIZUAR UDHËTIME NË SLLOVENI (2008), MAQEDEINI (2009), ARMENI (2011), BULLGARI (2013) DHE GJEORGJI (20015). KORI KA PLANIFIKUAR VIZITËN E RRADHËS NË SHQIPËRI NË MUAJIN PRILL 2017.

PROGRAMI I KORIT “KËNGËTARËT UDHËTUES TË UTRECHTIT” PËRMBAN DISA KËNGË HOLLANDEZE, POR MË SË SHUMTI REPERTOR TË MUZIKËS KORALE NGA SHUMË VENDE DHE ME STILE TË NDRYSHME. KORI SYNON TË BËJË PJESË TË REPERTORIT TË TIJ KËNGË TË MUZIKËS MODERNE DHE TRADICIONALE TË VENDIT PRITËS. SHUMICA E KËNGËVE TË UTS, JANË TË PERFORMUARA A CAPELLA, E DISA PREJ TYRE ME SHOQËRIM.



SHOQATA MIQTË E MUZIKËS “ROZAFa EXPRESSION”

SHOQATA MIQTË E MUZIKËS “ROZAFa EXPRESSION”, ËSHTË KRIJUAR NË VITIN 1999 ME INICIATIVEN E DIRIGJENTIT DHE KOMPOZITORIT PROF. ZEF ÇOBA. EMËRTIMI I KËSAJ LËVIZJE, PËRBËN SINTEZEN E DETYRIMIT QYTETAR E ARTISTIK TË ANËTARËVE.”ROZAFa”, KALAJA DËSHMI E HISTORISË 2400 VJEÇARE E QYTETËRIMIT NË SHKODËR, ME LEGJENDËN SIMBOLIZON SAKRIFICEN, SHPREHJE E DETYRIMIT QYTETAR. NDËRSA DETYRIMI ARTISTIK, QËNDRON NË REALITETET ARTISTIKE TË NDËRTUARA MBI EKSPRESIVITETIN E VLERAVE MUZIKORE. AJO ËSHTË VAZHDUESE E APLIKIMEVE ARTISTIKE TË ZHVILLUARA NGA INSTITUCIONET KRYESORE TË QYTETIT, E PARAQITET SI NJË PRAKTIKË E KONSOLIDIMIT DHE INTEGRIMIT TË VLERAVE, NË HAPËSIREN E KRIJUAR NË SHQIPËRI PAS VITEVE 90-TË. KA KATER SEKSIONE: KORIN ”ROZAFa EXPRESSION”, GRUPIN VOKAL “LOJA E NOTAVE MUZIKORE” PËR FORMIMIN MUZIKOR TË FËMIJËVE DHE TË RINJËVE, “NË LULISHTEN E KËNGËS SHKODRANE” PËR EDUKIMIN E KËNGËTARËVE TË RINJË, DHE “MIQTË E MUZIKËS”.

KA ORGANIZUAR PREMIERA E KONCERTE NË SHKODËR, TIRANË, DURRËS, FIER, KORÇË; ULQIN, CETINJE E TUZ TË MALIT TË ZI ; TURNE NË QENDRA TË NDRYSHME TË NAPOLIT, KONCERTE PERVJETORESH, E SHFAQJE NË SHTËPI FËMIJËSH, SHTËPI TË MOSHUARISH, SPITALE, SHKOLLA ETJ. KA MARRË PJESË ME SUKSES NË FESTIVALE NDËRKOMBETARE KORALE NË SHQIPËRI, GREQI, ITALI, SERBI, MAQEDONI, KOSOVË.

PËR HERË TË PARË NË SHQIPËRI, ORGANIZON KONCERTIN «VIVA LA MUSICA» NË DITEN BOTËRORE TË MUZIKËS(21 QERSHOR). STUDENTË TË UAT, KANË DIPLOMUAR ME KONCERTE KORALE. SHOQATA, KA QENDRËN E KËNDIMIT KORAL DHE SALLEN E AKTIVITETEVE "MARIANNE GRAF", MUNDËSUAR NGA SHOQATA ALBANIA – AUSTRIA. AKTIVITETI I SHOQATËS MUNDËSOHET FALË PUNËS HUMANE E ME PASION TË ANËTARËVE, KONTRIBUTIT TË TYRE, DONATORËVE, MBËSHTETJA E TË CILËVE ËSHTË INKURAJIM NË TË MIRË TË EDUKIMIT, GJALLËRIMIT TË JETËS ARTISTIKE, SI DHE DIALOGUT NDËRMJET KULTURAVE.

PROF. ZEF ÇOBA KA LINDUR NË SHKODËR NË VITIN 1951. NË VITIN 1974 MBARON STUDIMET NË ILA TIRANË NË DEGEN E DIRIGJIMIT KORAL. KA PUNUAR NË PESHKOPI E MË PAS NË SHKODËR PRANË SHTËPIVE TË KULTURËS SË KËTYRE QYTETEVE, ME DETYRËN E PËRGJEGJËSIT TË MUZIKËS. NË VITIN 1989 DEL NË PROFESION TË LIRË. NË VITIN 1991 FILLON PUNË NË RADIO – SHKODRA, GAZETAR I EMISIONEVE DHE PROGRAMEVE MUZIKORE, SI DHE KRYEREDAKTOR. NGA VITI 2003 ËSHTË PEDAGOG PRANË FAKULTETIT TË MUZIKES NË UNIVERSITETIN E ARTEVE TIRANË. JEP LEKSIONE PRANË UNIVERSITETIT “LUIGJ GURAKUQI” TË SHKODRES, NË DEGËN E PEDAGOGJISË MUZIKORE, NË LËNDËT E DIRIZHIMIT KORAL DHE EDUKIMIT KORAL. KA DHËNË KONTRIBUT SI DIRIGJENT I KORIT TË KATEDRALES SHKODER(‘97-‘01), KATEDRALEN “SHËN PALI” TIRANË(2004). NGA VITI 2010, DREJTON KORIN E KISHËS SË SHËN FRANCESKUT GJUHADOL-SHKODER.

KA KOMPOZUAR MUZIKË VOKALE, INSTRUMENTALE, MUZIKEN E 16 FILMAVE ARTISTIKË, MUZIKË PËR TEATËR, PËRPUNIME, KËNGË NË STIL TË TRADITËS SË KËNGËS QYTETARE SHKODRANE, PËR FËMIJË ETJ., SHUMË PREJ TË CILAVE KANË FITUAR POPULLARITET ABSOLUT. GJITHNJË ËSHTË KARAKTERIZUAR NGA NJË PUNË ME DISIPLINË E KERKESA TË LARTA ARTISTIKE. SI MBRENDIA DHE JASHTË VENDIT, ËSHTË VLERËSUAR ME KONSIDERATA TË LARTA, ÇMIME TË NDRYSHME DHE SHUME TITUJ NDERI. MBAN TITULLIN PROFESOR DHE ËSHTË ANËTAR I FORUMIT KORAL BALLKANIK.